

THE IMPORTANCE OF PEDAGOGICAL TRANSLATION IN TEACHING A FOREIGN LANGUAGE

Shejnaze AJDINI-MURTEZI¹, Besa SALIU²

^{1*} Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians - Skopje

² High School of Music „Todor Skalovski - Tetoec“ - Tetovo

e-mail: shejnaze.ajdini@unite.edu.mk

Abstract

This paper deals with the subject of teaching a foreign language through translation. In this case, the foreign language is French, while the mother tongue is the Albanian language. Pedagogical translation is of particular importance in the development of students' abilities and in a better understanding of idiomatic locutions and expressions in both languages. The purpose of this paper is to highlight that foreign language translation and teaching in a communicative environment have many essential commonalities. Discovering the message in a foreign language text by understanding the words that constitute that language and adapting to context and situation, provide the learner the ability to express and convey messages based on different texts in the relevant language. To achieve this purpose, we visited a high school in Kumanovo, where we reviewed written papers of 15 students (translation: French-Albanian).

Keywords: Translation, pedagogical, French language, teaching, students.

Përmbledhje

Ky punim ka të bëjë me mësimdhënien e gjuhës së huaj nëpërmjet përkthimit. Në këtë rast gjuha e huaj është gjuha frënge, ndërsa gjuhë amtare është gjuha shqipe. Përkthimi pedagogjik ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe në të kuptuarit më të mirë të lokucioneve dhe shprehjeve idiomatike në të dyja gjuhët. Qëllimi i këtij punimi është që të vërë në pah se përkthimi dhe mësimi i gjuhës së huaj në një mjedis komunikativ kanë shumë synime themelore të përbashkëta. Zbulimi i mesazhit në një tekst të gjuhës së huaj duke u nisur nga kuptimi i fjalëve që e përbëjnë atë dhe përshtatja e kontekstit dhe situatës, i mundësojnë nxënësit që të jetë në gjendje edhe të shprehet dhe të përçojë mesazhe bazuar nga tekste të ndryshme në gjuhën përkatëse. Për të arritur këtë qëllim, ne kemi prezentuar në një shkollë të mesme të Kumanovës, ku kemi shqyrtuar punimet me shkrim të 15 nxënësve (përkthim: gjuhë frënge-gjuhë shqipe).

Fjalët kyçe: Përkthim, pedagogjik, gjuhë frënge, mësimdhënie, nxënës.

1. Hyrje

Ky punim i përket didaktikës së gjuhës frënge si gjuhë e huaj, ku ne do të shtjellojmë rolin e përkthimit në orët mësimore, përkatësisht rolin e përkthimit pedagogjik të gjuhës frënge për t'iu përgjigjur pyetjes në vazhdim: - Cilat janë përparësitë e përkthimit në orët mësimore të gjuhës së huaj? Në fakt, qëllimi kryesor është që të kuptojmë nëse përkthimi mund të ndihmojë ose, në të kundërtën, të pengojë në mësimdhënien, gjegjësisht në mësimnxënien e gjuhës së huaj. Për t'i studiuar këto elemente, ne kemi filluar kërkimin tonë duke bërë një ekperimentim me 15 nxënës të vitit IV të gjimnazit „Sami Frashëri“ të Kumanovës të cilët i janë nënshtruar një provimi me shkrim. Pra, korpusi ynë është i themeluar nga kopjet e provimit të cilin e kemi realizuar gjatë vitit shkollor 2018/2019. Për t'i mbledhur të dhënat në lidhje me këtë hulumtim, nxënësve u është

dhënë një tekst në gjuhën frënge («Éloge de la curiosité») dhe u është kërkuar që ta përkthejnë në gjuhën amtare, përkatësisht në gjuhën shqipe. Për trajtimin e të dhënave, kemi përdorur metodën kualitative. Gabimet janë klasifikuar në tri kategori: kohezive, morfosintaksore dhe leksikore. Pasi e kemi kontrolluar çdo kopje, ne i kemi ndarë llojet e gabimeve sipas kategorive.

2. Zhvillimi i metodave të mësimdhënies dhe përkthimi

Për të pasur një pasqyrë më të qartë sa i përket vendit që zë përkthimi në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, na duket e përshtatshme të paraqesim një përmbledhje të shkurtër në lidhje me rëndësinë që i është dhënë atij në metodat e ndryshme të mësimdhënies. Didaktika e gjuhëve të huaja në mënyrë të vazhdueshme është në kërkim të metodave të reja me qëllim që t'u përgjigjet nevojave të mësimdhënies/mësimnxënies. Sipas fjalëve të Christian Puren, didaktika e gjuhëve të huaja gjendet gjithnjë “në kryqëzim të metodave”. Në fakt, metodat që kanë vijuar njëra-tjetrën kishin një pozitë më të favorshme apo më pak të favorshme sa i përket përkthimit, pa pasur mundësi që ndonjëra prej tyre të imponohet më pak ose më shumë në dëm të tjetrës (Puren, 1994, 19).

Përkthimi gjatë orës mësimore të gjuhës së huaj ka qenë një kohë të gjatë një proces i kontrollit dhe madje edhe një mjet i mësimin të strukturave leksikore dhe gramatikore. Përkundër heshtjes së manifestuar kundër përdorimit të tij në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, përkthimi nuk është hequr asnjëherë tërësisht. Ai ka vazhduar të zërë një vend, i cili ka pasur rënie e ulje të pandërprera në funksion të metodologjive të pranishme. Mund të thuhet se përkthimi ka ekzistuar gjithnjë gjatë orëve mësimore, por megjithatë në shkallë të ndryshme, nga metoda tradicionale, direkte, aktive, audio-orale dhe audio-vizuele.

Në metodën tradicionale, përkthimi ishte mjeti i vetëm për të përvetësuar një gjuhë të huaj. Derisa, më pas, në kuadër të metodës audio-orale, kalimi në gjuhën amtare ishte hequr plotësisht, metoda e re e qasjes komunikative, përkthimin e rikthen përsëri në skenë. Aktualisht, dhe sipas autorëve të *Portfolio européen des langues*, mësimi i një gjuhe synon aftësi më të mëdha. Përkthimi vendoset midis prodhimeve të tjera me shkrim. Nëse përkthimi mund të përbëjë një mjet për të mësuar vokabularin, ai gjithashtu është konsideruar si një nga aktivitetet e prodhimit me shkrim dhe ndërmjetësimin.

3. Roli i përkthimit në mësimdhënien e gjuhës së huaj

Më herët, ndër shekuj, përkthimi ishte i njohur për kontributet e tij mjaft të rëndësishme në interpretimin e kulturave dhe civilizimeve të ndryshme si edhe në popullarizimin e shkencës dhe teknologjisë. Siç shprehet edhe Jean-René Ladamiral, përkthimi është profesioni i dytë më i vjetër në fushën e studimeve, ai është gjithnjë pjesë e shoqërisë sonë ku askush nuk mund të jetë i pavarur nga ai (Ladamiral, 1994, 44).

[...] Përkthimi përgjithësisht është kuptuar si një ushtrim i kërkimit të ekuivalencave në mes dy teksteve të shprehura në dy gjuhë të ndryshme. Por, meqë gjuhët nuk janë sisteme izomorfe, asnjëherë nuk është e mundur të bazohemi në ekzistimin e korrespondencave të shprehjeve

(lokucioneve) në njëren gjuhë dhe në tjetrën, që do të thotë në ekzistimin e një identiteti semantik pavarësisht nga format e ndryshme (Cuq, 2003, 239).

Sipas Élisabeth Lavault' përkthimi që e përdorim gjatë orës së gjuhës së huaj quhet përkthim pedagogjik. Përkthimi pedagogjik përfshin jo vetëm ushtrimet, por të gjitha rastet kur mësimdhënësi e përdor gjuhën amtare të nxënësve (Lavault, 1998, 21). Kjo ndodh sidomos në rastin kur ai konsideron se një përkthim brendagjuhësor (intralingual) i një fjale apo i një shprehjeje, nuk është i mundur apo është i pamjaftueshëm. Pra, nuk bëhet fjalë për një nevojë absolute, por më shumë për një lehtësim që kursen dhe që shkon në drejtim të efikasitetit dhe saktësisë. Kështu referimi në gjuhën amtare është i domosdoshëm, të paktën i dëshirueshëm, në rastin kur qëllimi thelbësor është didaktik. Përkthimi pedagogjik në përgjithësi përdoret gjatë orës së gjuhës së huaj me qëllim që t'i ndihmojë nxënësve në përvetësimin e gjuhës në fjalë. Ai mundëson të kontrollohet gjuha e mësuar në mënyrë didaktike.

Bazuar në zhvillimet kërkimore-shkencore në didaktikë, por edhe zhvillimet politike, ekonomike, sociale e kulturore në botë, janë shfaqur dhe kanë evoluar metodologji të shumta Sot, metodologjitë e reja i japin përparësi një teorie të përkthimit ku gjuha amtare e rimerr vendin e saj dhe, në këtë mënyrë, mundëson krahasimin midis gjuhëve dhe nxit përkthimin. Gjithashtu, duke u mbështetur në kërkimet psikolinguistike dhe reflektimet e shumë mësimdhënësve, mendohet se gjuha amtare është më shumë si një filtër apo si një kalim i detyrueshëm sesa si pengesë.

Me këtë nënkuptohet se përkthimi kthehet gjatë orëve të gjuhëve të huaja, si për t'i shkurtuar sqarimet e gjata në gjuhë të huaj, ashtu edhe për të shërbyer si pikë krahasimi në mes dy sistemeve gjuhësore. Posaçërisht në fushën e leksikut dhe të gramatikës, përdorimi krahasues i përkthimit mundëson në tërheqjen e vëmendjes së nxënësve mbi konvergjenat dhe divergjencat gjuhësore dhe, nga ana tjetër për mënyrën se si gjuha amtare mund të përdoret si trampolinë për të mësuar gjuhën e huaj (Chadelat, 1997, 4).

Megjithëse, ka shumë vite që përkthimi e ka rimarrë vendin e tij në orë të gjuhëve të gjalla, statuti si edhe dobia e tij nuk janë ende të përcaktuara qartë, as nga teoritë bashkëkohore kryesore didaktike, as nga praktikat pedagogjike të përditshme të mësimdhënësve. Pa dyshim kjo pasiguri është ndoshta, për pjesën më të madhe, rezultat i përçarjes teorike dhe eklipsës historike ku përkthimi ishte qëllim gjatë një periudhe të gjatë, por i papërfillshëm në një periudhë caktuar. Prandaj, këtu duhet marrë parasysh funksionet e ndryshme pedagogjike që i janë caktuar përkthimit dhe roli që i është dhënë atij në një qasje koherente didaktike. Nuk mund të mohohet kontributi i përkthimit në mësimdhënien /mësimnxënien e gjuhës së huaj. Në përgjithësi është pranuar se përkthimi është një mjet efikas, shpesh i nevojshëm për mësimin e gjuhës së huaj.

Si një aktivitet i orës mësimore, ai shërben për t'i përforcuar njohuritë në gjuhën e huaj. Në realitet, përkthimi pedagogjik kërkon nga njëra anë njohuri dhe shkathtësi të mjaftueshme në të dy gjuhët dhe nga ana tjetër aftësi për të analizuar. Për të realizuar një përkthim, nxënësi duhet t'i mobilizojë aftësitë e tij të të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim, që do t'i shërbejnë për t'i zhvilluar kapacitetet e tij për të kuptuar, analizuar dhe për të përkthyer në mënyrë adekuate. Në fakt, dihet mirëfilli se një fjalë në gjuhën amtare nuk mund të ketë gjithnjë një ekuivalent standard

dhe të qëndrueshëm në gjuhën e huaj. Pra një fjalë e tillë do të mundej të përkthehet me një përkthim, interpretim, metaforë, etj.

Duke dashur ta rikthejë praktikën e përkthimit në orët e gjuhës, Michel Ballard propozon një ushtrim për komentimin e versionit, përkatësisht të përkthimit të tekstit nga gjuha e huaj në gjuhën amtare, një ushtrim ku nxënësi duhet të krahasojë tekstin original dhe atë të përkthyer, të gjejë dallimet midis dy teksteve në planin leksikor, gramatikor, etj. dhe të komentojë këto dallime (Ballard, 1988, 341). Sipas tij, ky është një aktivitet i nevojshëm për arsye se nxënësit i ndihmon të formojë një koncept në lidhje me specifikat e të dy sistemeve gjuhësore dhe më pastaj të diskutojë në lidhje me zgjedhjen e ekuivalencave gjatë përkthimit.

4. Metodologjia dhe korpusi

Siç e cekëm edhe në hyrje, synimi i këtij punimi është që të studiohet roli i gjuhës amtare në procesin e mësimdhënies/mësimdhënies në orët e gjuhës frënge në mënyrë që të shihet realiteti në lidhje me qasjen e të përkthyerit, duke i inkurajuar nxënësit që të vënë në pah njohuritë e tyre me anë të përkthimit. Ne kemi shqyrtuar këtë temë për të parë se çfarë rëndësie ka dhe çfarë roli luan përkthimi në pasurimin e leksikut dhe në përvetësimin e strukturës gramatikore të gjuhës frënge.

Në fakt për të arritur këtë synim, kemi realizuar një provim me shkrim me 15 nxënës të vitit IV të gjimnazit „Sami Frashëri“ të Kumanovës, të cilëve u është dhënë një tekst për përkthim nga gjuha frënge në gjuhën shqipe. Analiza e teksteve të përkthyer në gjuhën shqipe, gjegjësisht krahasimi i tyre me tekstin në gjuhën frënge, na ka mundësuar t'i vërejmë në mënyrë më konkrete dimensionet leksikore e gramatikore të pikave të pëbashkëta dhe të dallimeve në mes dy gjuhëve përkatëse.

Pra, për trajtimin e të dhënave kemi përdorur metodën kualitative. Gabimet janë klasifikuar në tri kategori: kohezive, morfosintaksore dhe leksikore. Pasi e kemi kontrolluar çdo kopje, llojet e gabimeve i kemi ndarë sipas kategorive në fjalë.

5. Rezultatet

Rezultatet e analizës së gabimeve i kemi paraqitur me anë të tabelës1.

Tabela 1. Llojet e gabimeve gjatë përkthimit.

Fjalitë	F1	F2	F3	F4	F5	F6	F7	Gjithsej	%
Kategoritë e gabimeve									
Kohezive	4	5	3	3	4	2	3	24	34,78
Morfosintaksore	5	4	5	3	3	4	4	28	40,57
Leksikore	4	3	3	2	2	1	2	17	24,63

Në vijim kemi dhënë sa për ilustrim vetëm disa nga fjalitë e kontrolluara të kopjeve të nxënësve (1a, 1b - 2a, 2b - 3a,3b – 4a, 4b, 5a, 5b - 6a, 6b – 7a, 7b)

1. *Encore conviendrait-il de préciser la nature de cette curiosité et d'en connaître les auteurs ?*
(A do të ishte ende e nevojshme të saktësohet natyra e kësaj kureshtje dhe të njihen autorët e saj ?)

1a. Do të ishte e këshillueshme që të specifikoni natyrën e këtij kurioziteti dhe autorët.

1b. A do të ishte ende e nevojshme të qartësohen natyra e kësaj kurioziteti dhe e njohur për autorët.
- gabime morfosintaksore (kësaj kurioziteti)

2. *Si c'est d'être coupable que de vouloir découvrir ce qui appartient à la vie privée des gens, il est, en revanche, fort louable d'acquérir chaque jour de nouvelles connaissances.*

(Nëse konsiderohemi fajtor për faktin se dëshirojmë të zbulojmë gjërat që i përkasin jetës private të njerëzve, përkundrazi është e preferueshme që çdo ditë të përvetësojmë njohuri të reja.)

2a. Nëse dëshironi ta zbuloni fajtorin se çfarë i përkiste jetës personale të njerëzve, është një anë e lavdërueshme të fitoni njohuri të reja çdo ditë.

2b. Nëse do të jetë fajtor që dëshironi të zbuloni se çfarë i përket jetës private të njerëzve, nga ana tjetër, është shumë e lavdërueshme për të përvetësuar njohuri të reja çdo ditë.

- gabime morfosintaksike (nëse do të jetë fajtor që dëshironi, ta zbuloni fajtorin se çfarë i përkiste jetës...)

3. *Alors que 'les grandes personnes', parfois par timidité, parfois par paresse, souvent par indifférence, hésitent à se poser des questions, les enfants, eux, ne s'en privent point.*

(Derisa 'të rriturit', nganjëherë nga ndruajtja, nganjëherë nga përtacia, shpesh nga indiferenca, ngurrojnë të parashtrajnë pyetje, fëmijët nuk e privojnë aspak veten prej tyre.)

3a. Ndërsa 'të rriturit', ndonjëherë të turpshëm, ndonjëherë përtac, shpesh përmes indiferentizmit, nuk kanë dëshirë të bëjnë pyetje, fëmijët nuk i mungojnë.

3b. Ndërsa 'të rriturit', ndonjëherë me frikë, dembel, shpesh përmes të qenurit indiferent, nuk kanë dëshirë të pyesin, fëmijët nuk iu mungojnë.

- gabime leksikore (frikë, indiferentizëm), gabime kohezioni (Ndërsa 'të rriturit', ..., nuk kanë dëshirë të bëjnë pyetje, fëmijët nuk i mungojnë)

4. *Or, précisément, tout intéresse les enfants et ce n'est pas demain que les réponses doivent leur être données, mais aujourd'hui.*

(Megjithatë, më saktësisht, fëmijëve u intereson gjithçka dhe përgjigjet duhet t'iu jepen menjëherë e jo më vonë (sot dhe jo nesër).

4a. Pra më saktë të gjithë fëmijët janë të interesuar dhe nuk duhet që nesër t'iu jepen përgjigjet.

4b. Por, saktësisht, të gjithë fëmijët janë të interesuar dhe nuk është nesër që përgjigjet duhet t'iu jepen atyre, por sot.

- gabime morfosintaksike (nuk është nesër që përgjigjet)

5. *J'ignore si l'on devient très savant en questionnant à tout propos et sur toutes choses, mais je suis certain que c'est une preuve de modestie.*

(Nuk e di nëse dikush bëhet i ditur duke parashtruar pyetje në çdo rast dhe për të gjitha gjërat, por jam i sigurt se kjo është një shenjë e modestisë.)

5a. Nuk e di nëse dikush bëhet shumë studius duke pyetur për të gjitha, por shumë e sigurt është një dëshmi e modestisë.

5b. Nuk e di nëse dikush bëhet shumë studius duke pyetur gjithçka për të gjitha, por shumë i sigurt një dëshmi e modestisë.

- gabime morfosintaksike (gjithçka për të gjitha)

.....
6. *Nous connaissons tant de Monsieur-je-sais-tout et de Mademoiselle-parce-que, haut de trois pommes et déjà si sûrs d'eux, qu'il est en définitive bien agréable de renseigner, autant qu'il est possible, les enfants curieux de tout savoir.*

(Ne njohim aq Zotëri-unë di gjithçka dhe Zonjusha-përshkak se, aq të vegjël dhe shumë të sigurtë në vetvete, prandaj në fund të fundit është shumë e këndshme t'i informojmë aq sa është e mundur fëmijët kureshtarë që dëshirojnë të dijnë gjithçka.)

6a. Ne dimë kaq mirë për Zotëriun dhe Zonjushën, i lartë sa tri mollë dhe tashmë të sigurt për vete, sa më në fund është mirë të informosh, sa të jetë e mundur, fëmijët kuriozë të dinë gjithçka.

6b. Ne dimë kaq mirë për Zotëriun dhe Zonjushën e lartë prej 3 mollë dhe tashmë të sigurt në to, më në fund, është të informosh, sa të jetë e mundshme të fëmijët kuriozë të dihet gjithçka.

- gabime leksikore (3 mollë, ...), gabime morfosintaksike (...te fëmijët kuriozë të dihet gjithçka,...).

.....
7. *Ainsi entendue, la curiosité n'est-elle pas, alors, une précieuse qualité ?*

(E kuptuar në këtë mënyrë, pra, a nuk është kureshtja një cilësi e çmuar ?)

7a. Është dëgjuar, a nuk është kurioziteti cilësi e çmuar?

7b. Ashtu dëgjuar, a nuk është kurioziteti cilësi e çmuar?

- gabime morfosintaksore (është dëgjuar, a nuk është, ... ashtu dëgjuar), ...

.....
Rezultatet e mësipërme paraqesin shpërndarjen e gabimeve sipas kategorive. Në bazë të rezultateve mund të vërejmë qartë një dallim në kategorinë e gabimeve. Shihet se llojet e gabimeve të kohezionit paraqesin 34,78%. Këtu vjen në shprehje transferi pozitiv i cili paraqitet gjatë përkthimit nga gjuha frënge në gjuhën shqipe, në rastet kur nxënësi nuk mund të gjejë lehtë ekuivalentët e tyre në gjuhën amtare, përkatësisht në gjuhën shqipe. Këtu, kemi vërejtur gjithashtu se një numër i caktuar i nxënësve ka probleme gjatë të shprehurit me shkrim në gjuhën amtare. Kështu, në fjalinë: « Ndërsa 'të rriturit' nuk kanë dëshirë të bëjnë pyetje, fëmijët nuk i mungojnë », nuk ka kohezion semantik, që do të thotë se fjalia e përkthyer nuk është shumë e kuptueshme, çka në fakt mund të thuhet se nxënësi është bazuar në ekuivalencën formale (fjalë për fjalë) duke mos e marrë parasysh kuptimin e saj.

Gabimet morfosintaksike-sintaksike paraqesin 40,57% nga gabimet e përgjithshme. Vështirësitë qëndrojnë sidomos në nivelin e përkthimeve të sintagmave foljore e emërore. Në

fjalinë «... ce qui appartient à la vie privée des gens», është përkthyer «... se çfarë i përkiste jetës personale të njerëzve», pra folja « appartient » e cila është në kohën e tashme në gjuhën frënge, është përkthyer « i përkiste » në gjuhën shqipe, pra në kohën e pakryer.

Sa u përket gabimeve leksikore, ato paraqiten me një përqindje më të vogël, pra me 24,63%. Edhe këtu vjen në shprehje nga transferi pozitiv gjatë përkthimit të fjalëve në gjuhën amtare. Vështirësi të mëdha, në këtë rast, paraqesin edhe shprehjet idiomatike. Për shembull, shprehja « *haut de trois pommes* » që ka kuptimin *i vogël në moshë* ose *i shkurtër në madhësi*, është përkthyer fjalë për fjalë në gjuhën shqipe « i lartë sa tri mollë ».

6. Përfundimi

Në këtë punim modest, ne jemi përpjekur që të japim një vlerësim në lidhje me rëndësinë e rikthimit të përkthimit në mësimin e gjuhës frënge. Për këtë qëllim kemi analizuar gabimet me shkrim të nxënësve gjatë përkthimit nga gjuha e huaj në gjuhën amtare. Duke u nisur nga fakti se nxënësi i cili e mëson gjuhën frënge si gjuhë të huaj e përdor instinktivisht përkthimin, pa marrë parasysh se a është ai i lejuar ose jo gjatë orëve mësimore, është e rëndësishme të pyetemi se në çfarë mase qëndrojnë përparësitë e tij gjatë të mësuarit të së njëjtës. Thënë ndryshe, nëse përdorimi i përkthimit, gjegjësisht përdorimi i gjuhës amtare gjatë mësimin të gjuhës së huaj, e lehtëson përvetësimin e së dytës. Pikërisht në këtë prizëm, ne mendojmë se duke e përdorur përkthimin, nxënësit bëjnë më pak gabime në gjuhën e huaj. Me fjalë të tjera, përkthimi ndihmon në përmirësimin e cilësisë së prodhimeve me shkrim në gjuhën frënge.

Vlerësimi i teksteve të dhëna për përkthim na ka dhënë një pasqyrë të përgjithshme për numrin e gabimeve që i kanë bërë nxënësit. Ne i kemi analizuar këto tekste me qëllim që t'i përgjigjemi pyetjes sonë në lidhje me këtë hulumtim. Përkundër vështirësive linguistike, zgjedhjes së ekuivalentëve joadekuatë, shprehjeve të formulara me gabime, kemi konstatuar se nxënësit posedojnë aftësi përkthimi të cilën duhet zhvilluar më tej. Pra, përkthimi luan një rol mjaft të rëndësishëm në prodhimet me shkrim të nxënësve, duke ndikuar në përmirësimin e tyre si dhe në përvetësimin më të lehtë të gjuhës frënge.

Si përfundim i gjithë kësaj që u tha më lart, ne propozojmë që të hartohen programe që do t'u përshtateshin nxënësve të gjuhës frënge në funksion të specifikave të tyre, përkatësisht, një mësimdhënie që do të zhvillohej sipas një metode e cila nuk do ta largonte tërësisht përkthimin gjatë orëve mësimore.

Referencat

- [1]. Ballard, M. (1988). *Le commentaire de version*. Montréal: PUM.
- [2]. Chadalet, J.-M. (1996). *Quelques reflexions au sujet de l'enseignement du lexique*. Paris: APLIUT.
- [3]. Cuq, J.-P. (2003). *Dictionnaire de didactique du français*. Paris: CLE International.
- [4]. Ladmiral, J.-R. (1994). *Traduire : théorèmes pour la traduction*. Paris: Gallimard.
- [5]. Lavault, É. (1998), *Fonctions de la traduction en didactique des langues. Apprendre une langue en apprenant à traduire*. Paris: Didier.
- [6]. Mounin, G. (1963). *Les problèmes théoriques de la traduction*. Paris: Gallimard.
- [7]. Puren, Ch. (1994). *La Didactique des langues étrangère à la croisée des méthodes, essai sur l'éclectisme*. Paris: Didier.
- [8]. Tatilon, C. (1986). *Traduire. Pour une pédagogie de la traduction*. Paris: GREF.

7. Aneks

Disa nga tekstet e përkthyer të nxënësve

Texte à traduire en albanais

Éloge de la curiosité

On a coutume de dire que la curiosité est un vilain défaut. Encore conviendrait-il de préciser la nature de cette curiosité et d'en connaître les auteurs. Car on confond parfois indiscretion et curiosité. Si c'est être coupable que de vouloir découvrir ce qui appartient à la vie privée des gens, il est, en revanche, fort louable d'acquérir chaque jour de nouvelles connaissances. Alors que les 'grandes personnes', parfois par timidité, parfois par paresse, souvent par indifférence, hésitent à se poser des questions, les enfants, eux, ne s'en privent point. Et c'est très bien ainsi.

Or, précisément, tout intéresse les enfants et ce n'est pas demain que les réponses doivent leur être données, mais aujourd'hui. Toutes les réponses. Ou, enfin, presque toutes...

J'ignore si l'on devient très savant en questionnant à tous propos et sur toutes choses, mais je suis certain que c'est une preuve de modestie.

Nous connaissons tant de Monsieur-je-sais-tout et de Mademoiselle-parce-que, haut de trois pommes et déjà si sûrs d'eux, qu'il est en définitive bien agréable de renseigner, autant qu'il est possible, les enfants curieux de tout savoir. Ainsi entendue, la curiosité n'est-elle pas, alors, une précieuse qualité ?

Falenderimi i kuriotitetit.

Është zakon të themi se kuriotiteti është një gjë e keqe.
A do të ishte e këshillueshme gjë të specifikuni
natyrën e kësaj kuriotiteti dhe të njihni autorët.
Sepse nganjëherë ngatërrojme mosrespektimin
dhe kuriotitetin.

Nëse do të jetë faktur që dëshironi të zbulojnë
gjëra private të tjerëve, është nga
ana tjetër, shumë e lardbueshme për të përveçuar
njohuri të reja vetë.

Ndërsa të rikurrit ndonjëherë me turp, ndonjëherë
dembel. Shpesh herë edhe ferentë, hezitojnë të bëjnë
pyetje, fëmijet nuk janë në mendje. Dhe kjo është mirë.
Didakti është pikërisht interesi i fëmijëve dhe nuk
është e malkuar që pyetjet duhet t'u lejon atyre
por sot. Të gjitha pyetjet, do më në fund përkthehen
të gjitha.

Éloge de la curiosité

On a coutume de dire que la curiosité est un vilain défaut. Encore conviendrait-il de préciser la nature de cette curiosité et d'en connaître les auteurs. Car on confond parfois indiscretion et curiosité. Si c'est être coupable que de vouloir découvrir ce qui appartient à la vie privée des gens, il est, en revanche, fort louable d'acquérir chaque jour de nouvelles connaissances. Alors que les 'grandes personnes', parfois par timidité, parfois par paresse, souvent par indifférence, hésitent à se poser des questions, les enfants, eux, ne s'en privent point. Et c'est très bien ainsi.

Or, précisément, tout intéresse les enfants et ce n'est pas demain que les réponses doivent leur être données, mais aujourd'hui. Toutes les réponses. Ou, enfin, presque toutes...

J'ignore si l'on devient très savant en questionnant à tous propos et sur toutes choses, mais je suis certain que c'est une preuve de modestie.

Nous connaissons tant de Monsieur-je-sais-tout et de Mademoiselle-parce-que, haut de trois pommes et déjà si sûrs d'eux, qu'il est en définitive bien agréable de renseigner, autant qu'il est possible, les enfants curieux de tout savoir. Ainsi entendue, la curiosité n'est-elle pas, alors, une précieuse qualité ?

Parlerimi i kuriozitetit
 Është e rëndësishme të thuhet se kurioziteti është një
 defekt i vështirë. A do të ishte e mirë të gëzoheshim.
 Natyra e kësaj kurioziteti i njohu autorët. Sepse ndonjëherë
 përballimi me vështirësi dhe kuriozitet. Nëse është fajtor që e
 kërkojnë për privatisim e njëjtit. Ai është i gatshëm që do të
 dije të re mersa qerërit e modërit shpesh nga
 imodestimi, hezitimi të bëjnë pyetje për fëmijët.
 Por gjithatë është e interesuar për fëmijët dhe nuk është
 meser që të përgjigjet duhet për të dhënë. Të gjithë
 nuk e dim nëse bëhemi të shpirtërore përdite pyetjen
 për të gjitha gjërat por anë jani një provë e
 imodestisë. Dëni në tre jemi të sigurt për ta
 se është padishti shumë e behtar për të pyetur
 ag sajim fëmijët e mureshim kuriozë për të
 diturë gjithatë. Jështa jam shigjetat është kurioz
 iteti. Do të kërkojë a cilësia e qmukt?

Texte à traduire en albanais

Éloge de la curiosité

On a coutume de dire que la curiosité est un vilain défaut. Encore conviendrait-il de préciser la nature de cette curiosité et d'en connaître les auteurs. Car on confond parfois indiscrétion et curiosité. Si c'est être coupable que de vouloir découvrir ce qui appartient à la vie privée des gens, il est, en revanche, fort louable d'acquérir chaque jour de nouvelles connaissances. Alors que les 'grandes personnes', parfois par timidité, parfois par paresse, souvent par indifférence, hésitent à se poser des questions, les enfants, eux, ne s'en privent point. Et c'est très bien ainsi.

Or, précisément, tout intéresse les enfants et ce n'est pas demain que les réponses doivent leur être données, mais aujourd'hui. Toutes les réponses. Ou, enfin, presque toutes...

J'ignore si l'on devient très savant en questionnant à tous propos et sur toutes choses, mais je suis certain que c'est une preuve de modestie.

Nous connaissons tant de Monsieur-je-sais-tout et de Mademoiselle-parce-que, haut de trois pommes et déjà si sûrs d'eux, qu'il est en définitive bien agréable de renseigner, autant qu'il est possible, les enfants curieux de tout savoir. Ainsi entendue, la curiosité n'est-elle pas, alors, une précieuse qualité ?

Lavderimi i kuriozitetit

Është zakon të thuhet se kurioziteti është një gjë e keqe. Përsen do të ishte e këshillueshme që të specifikoni natyrën e kësaj kurioziteti dhe të njihni autorët. Sepse nganjëherë ngatërrojme indekskrecionin dhe kuriozitetin. Nëse do të jete fjalor që dëshironi të zbuloni se çfarë i përket jetës private të njëzëre, është, nga ana tjetër, shumë e lavdërueshme të fitoni çdo ditë njohuri të reja.

Ndërsa, njëzërit e mëdhenj, ndonjëherë me kohë, ndonjëherë dëmbetë, shpesh nga indiferentizmi, hezitojnë të bëjnë pyetje, fëmijët nuk e privojnë veten prej saj. Përkundrazi është mirë gjithashtu.

Por, saktësisht, të gjithë fëmijët janë të interesuar dhe nuk është nëse që përgjigjet duhet t'u jepen atyre, por sot. Të gjitha përgjigjet. Ose, më në fund, pothuajse të gjithë...

Nuk e di nëse dikush bëhet shumë i mekur dhe bërë pyetje për gjithëkujt dhe gjithëkujt, por jam i sigurt që është një dëshmi e modestisë.